




Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut  
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

**KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT**  
**Nr. 02-060/01-0061628-4/24 dt. 23.09.2024**  
**Mitrovicë**



Në bazë të nenit 12 dhe 14, të Ligjit nr.03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, Nr. 28/15, qershor 2008); të nenit 24 dhe 25, të Ligjit Nr.06/L-092, Për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, Nr.10/03, prill 2019); të nenit 29 dhe 31, të Rregullores (QRK) nr. 09/2020, për Përcaktimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës; nenit 13 dhe 15, të Statutit të Komunës së Mitrovicës së Jugut, Nr. 02/060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, si dhe në pajtim me Planin Zhvillimor Komunal dhe Planit Rregullues Urban “Qendra”. Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më dt. 23.09.2024 pasi shqyrtoi Propozim vendimin e Kryetarit të Komunës Nr.02-463/02-0049468/24 dt.23.07.2024 Për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi private të Arsi company SH.P.K. duke përfshi edhe objekti për banim/afarizëm, me Rekomandim të Komitetit për politikë dhe financa Nr.02-060/01-0059372-4/24 dt. 12.09.2024, sjell këtë:

**VENDIM**

**Për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi private të Arsi company SH.P.K.**

1. MIRATOHET Propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi private të Arsi company SH.P.K.
2. Sipas pikës 1 të këtij Vendimi Parcela Kadastrale P-71208072-03826-3, në sipërfaqe prej  $S=11m^2$  nga sipërfaqja e përgjithshme prej  $S=14m^2$  në Pronësi të Komunës së Mitrovicës së Jugut me vendndodhje “Takovska” Z.K. Mitrovicë KËMBEHET me: Parcelën Kadastrale P-71208072-01289-4, me sipërfaqe të përgjithshme prej:  $S=11m^2$ , në Pronësi të private të Arsi company SH.P.K. me vendndodhje “Takovska”, Z.K. Mitrovicë.
3. Prona e paluajtshme e komunës e cekur në pikën 2 (dy) të këtij vendimi këmbëhet për qëllim të përmbushjes së interesit publik zgjerimin të Rrugës “Ali Zeneli”, në kuadër të Planit Rregullues Urban “Qendra”.
4. Pronat e paluajtshme që këmbëhen, sipas pikës dy të këtij vendimi duhet të evidentohen në librat kadastral të Komunës.
5. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm.
6. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë:
  - 6.1 Certifikatat e njësive kadastrale: P-71208072-03826-3 i dt. 24.06.2024 dhe P-71208072-01289-4 dt. 24.06.2024.
  - 6.2 Kopjet e planit të njësive kadastrale: P-71208072-03826-3 i dt. 24.06.2024 dhe P-71208072-01289-4 dt. 24.06.2024

- 6.3 Vendimi i Kuvendit të Komunës Nr.02-060/01-0072246/20-3 dt. 26.11.2020 Për trajtim me prioritet të rrugëve “Ali Zeneli” dhe ”Lah Nimani”,
- 6.4 Kërkesa për vlerësim të pronës Nr. 15-030/04-0033465/24 dt. 17.05.2024
- 6.5 Raport Vlerësimi nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve - Departamenti i Tatimit ne Pronë Nr.202-1/2024 dt. 29.05.2024,
- 6.6 Vërtetime se pronat nuk janë në hipotekë, barrë tatimore apo masë të sigurisë.
7. Vendimi shpallet pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

**Mitrovicë**



**Kryesuesja e Kuvendit**

  
**Vesa BROJA**

**Dorëzohet:**

**1 x 1 Kryesueses së Kuvendit**

**1 x 1 MAPL**

**1 x 1 Arkivit**

**Kopje: Kryetarit të Komunës**

**DGJKP**

**DPU**